



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 61

Gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1074, datë 23.7.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për shpërblimin e disa sportistëve, që kanë arritur rezultate të larta në kampionatin europian të peshëngritjes dhe në kampionatin europian të mundjes, si dhe të trajnerëve të tyre	3
Vendim i KM nr.1169, datë 13.8.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve për kurimin e z. Gëzim Musabelliu, në spitalin privat “Balkan Alliance Medical Center”	3
Vendim i KM nr.1171, datë 20.8.2008	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Vlorës	4
Vendim i KM nr.1174, datë 20.8.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kurimin e znj. Adriana Gjonaj, në Gjermani.....	4
Vendim i KM nr.1201, datë 27.8.2008	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 18.12.2007 për çështjen “Dybeku kundër Shqipërisë”	5
Vendim i KM nr.1213, datë 27.8.2008	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në Brazilia, Brazil.....	5
Vendim i KM nr.1267, datë 17.9.2008	Për shfuqizimin e vendimit nr.866, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i Unazës Shkodër”	6
Vendim i KM nr.1268, datë 17.9.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.835, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që u ofrohet investitorëve strategjikë”	6

Vendim i KM nr.1270, datë 17.9.2008	Për një shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve për kurimin e z. Bashkim Gazidede, në Itali.....	7
Vendim i KM nr.1271, datë 17.9.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.1034, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi, në buxhetin i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kryerjen e transplantit të veshkës, për disa shtetas, në Ankara, Turqi”	7
Vendim i KM nr.1293, datë 27.9.2008	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007 për çështjen “Driza kundër Shqipërisë”	8
Vendim i KM nr.1294, datë 27.9.2008	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007 për çështjen “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”	8
Vendim i KM nr.1317, datë 1.10.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, të ndryshuar.....	12
Vendim i KM nr.1320, datë 24.9.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”.....	13
Vendim i KM nr.1394, datë 17.10.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, në qytetin e Bajram Currit, Tropojë.....	15
Vendim i KM nr.1397, datë 17.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, me kohë të plotë, si dhe miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe, në Universitetin e Tiranës, në vitin akademik 2008-2009.....	16
Vendim i KM nr.1399, datë 17.10.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”, të ndryshuar	18
Vendim i KM nr.1400, datë 17.10.2008	Për organizimin e kurseve në SHISH dhe trajtimin e pjesëmarrësve.....	18
Vendim i KM nr.1403, datë 27.10.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.521, datë 8.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik”.....	19
Vendim i KM nr.1404, datë 25.10.2008	Për organizimin e ceremonisë mortore, në nderim të të ndjerit, z.Bashkim Gazidede.....	20

Vendim i KM nr.1428, datë 22.10.2008	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 18.12.2007 për çështjen “Marini kundër Shqipërisë”.....	21
Vendim i KM nr.1439, datë 29.10.2008	Për miratimin e rregullave dhe të procedurave të vlerësimit të veprimtarive e të projekteve, me ndikime të rëndësishme negative në mjedisin e vendeve fqinje.....	22
Vendim i KM nr.1447, datë 5.11.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin me dializë të një numri të sëmurësh me insuficiencë renale kronike.....	24
Vendim i KM nr.1448, datë 5.11.2008	Për miratimin e protokollit të bisedimeve ndërqeveritare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin për zhvillim, për vitin 2008.....	25
Vendim i KM nr.1460, datë 5.11.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.535, datë 4.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të Institutit të Studimit të Tokave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, të ndryshuar.....	25
Vendim i KM nr.1475, datë 12.11.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.598, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë””, të ndryshuar.....	26
Vendim i KM nr.1497, datë 19.11.2008	Për shtypjen e letrave me vlerë.....	26

VENDIM
Nr.1074, datë 23.7.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR SHPËRBLIMIN E DISA SPORTISTËVE, QË KANË ARRITUR REZULTATE TË LARTA NË KAMPIONATIN EUROPIAN TË PESHËNGRITJES DHE NË KAMPIONATIN EUROPIAN TË MUNDJES, SI DHE TË TRAJNERËVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë, për shpërblimin e disa sportistëve, që kanë arritur rezultate të larta në kampionatin evropian të peshëngritjes dhe kampionatin evropian të mundjes, si dhe të trajnerëve të tyre.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1169, datë 13.8.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z. GËZIM MUSABELLIU, NË SPITALIN PRIVAT « BALKAN ALLIANCE MEDICAL CENTER »

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për përballimin e shpenzimeve për kurimin e z. Gëzim Musabelliu, në spitalin privat “Balkan Alliance Medical Center”.

2. Efektet financiare, për mbulimin e shpenzimeve, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. PAGESA TË BËHET ME PARAQITJEN E FATURAVE ORIGJINALE TË INSTITUCIONIT TË KURIMIT.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1171, datë 20.8.2008

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Hasan Halili emërohet prefekt i qarkut të Vlorës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1174, datë 20.8.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E ZNJ. ADRIANA GJONAJ, NË GJERMANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 830 000 (tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve, për kurimin, në Gjermani, të znj. Adriana Gjonaj.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. PAGESA të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1201, datë 27.8.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 18.12.2007 PËR ÇËSHTJEN “DYBEKU KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 18.12.2007 për çështjen nr.41153/06, “Dybeku kundër Shqipërisë”, në shumën 5000 (pesë mijë) euro.
 2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 2 shtator 2008.
 3. Shuma 5000 (pesë mijë) euro të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit “Dybeku”, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.
 4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
 5. Detyrimi financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1213, datë 27.8.2008

PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË BRAZILIA, BRAZIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15, të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në Brazilia, Brazil.
 2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie do të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
 3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1267, datë 17.9.2008

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.866, DATË 12.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I UNAZËS
SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë“, dhe të pikës 3 të nenit 26 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr.866, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i unazës Shkodër”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1268, datë 17.9.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.835, DATË 11.6.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË
AKSIONEVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË ANONIME “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”, QË U OFROHET INVESTITORËVE STRATEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 7, 8 e 9 të ligjit nr.9889, datë 20.3.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e instruksioneve, për realizimin e tenderit për privatizimin e shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që i bashkëlidhet vendimit nr.835, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nën pikën 2.5.1 të pikës 2.5, “Afatet kohore të planit të punës”, plani i afateve kohore është sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në pikën 3.1.1, “Dokumente, që përbëjnë ofertën”, të bëhen këto shtesa:

i) Në nënndarjen “iii” të shkronjës “a”, pas fjalëve “... me inicialet e ofertuesit...”, të shtohen “... subjekt vetëm të: a) ndryshimit të kufizuar; b) ndryshimit të hapur, sipas pikës 5.2.1, më poshtë ...”.

ii) Në fund të shkronjës “b” shtohen fjalët “... subjekt vetëm i ndonjë ndryshimi, nëse është lejuar, sipas pikës 5.2.1 më poshtë...”.

c) Pika 3.2.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.2.4 Qëllimi i garancisë së ofertës është të sigurojë që ofertuesi fitues do të negociojë dhe zbatojë, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, pas njoftimit të ofertuesit fitues, marrëveshjen e blerjes së aksioneve, kryesisht në formën e kopjes së shënuar me initiale, të përfshirë në ofertën e tij, të ndryshuar vetëm për të vlerësuar:

i) ndryshime të vogla të projektit, për sqarimin, dhe të përfundimit të marrëveshjes së blerjes së aksioneve;

ii) këto ndryshime, nëse ka, të parashtruara në seksionet e shënuara, në përputhje me pikën 5.2.1, më poshtë, dhe të pranuar nga ofertuesi fitues dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

iii) BAFO SPA, sipas pikës 5.3.4, më poshtë.”.

ç) Shkronja “c”, e pikës 3.2.7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) nëse ofertuesi fitues dështon në negocimin dhe zbatimin e marrëveshjes së blerjes së aksioneve, në formën e kopjes me initiale, të përfshirë në ofertën e tij, të ndryshuar vetëm për të vlerësuar:

iv) ndryshime të vogla të projektit, për sqarimin, dhe të përfundimit të marrëveshjes së blerjes së aksioneve;

v) këto ndryshime, nëse ka, të parashtruara në seksionet e shënuara, në përputhje me pikën 5.2.1, më poshtë, dhe të pranuar nga ofertuesi fitues dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

vi) BAFO SPA, sipas pikës 5.3.4, më poshtë, ose...”.

d) Pika 3.6, “Çmimi i blerjes”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.6 Oferta financiare do të përmbajë çmimin e ofertuesit (Çmimi i kufizuar i blerjes), që duhet të shprehet si një sasi fikse, në euro, për t’u paguar për blerjen e shtatëdhjetë e gjashtë për qind (76%) të aksioneve të OSSH-së, bazuar në ndryshimin e kufizuar të marrëveshjes së blerjes së aksioneve. Oferta financiare mund të përmbajë, gjithashtu, një çmim indikativ blerjeje (“Çmimi i hapur i blerjes”) për t’u paguar në bazë të ndryshimit të hapur të marrëveshjes së blerjes së aksioneve.”.

dh) Në nënpikën 4.1.2 të pikës 4.1 “Vulosja dhe shënimi i ofertës”, afati “15 shtator 2008” zëvendësohet me “29 shtator 2008”.

e) Pika 5.2, “Vlerësimi i ofertave”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.2 Pas hapjes së secilës ofertë teknike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shqyrtojë ofertat teknike, për të përcaktuar nëse ato janë të plota dhe në përputhje me udhëzimet për ofertuesin. Marrëveshja e blerjes së aksioneve mund të paraqitet me një ndryshim të hollësishëm (projekti aktual i propozuar dhe jo koncepte të përgjithshme) (“Ndryshimi i kufizuar”), të nënpikave të mëposhtme (“Seksionet e kufizuara”):

- Titulli dhe garancia e detyrimeve;
- Kushtet parësore në mbyllje - vetëm referuar borxheve afatgjata të kreditorëve dhe PRG (kufizuar në miratimin e komitetit të veprimeve të BB-së);
- Mekanizmi i rregullimit të çmimit-referuar vetëm rregullimit të çmimit të blerjes;
- Justifikimi i borxhit të keq;
- Teprica e fitimit për RPS-në;
- Mekanizmi i kompensimit për të ardhurat e panjohura në tarifat e shitjes;
- Niveli i RoE-së;
- Niveli fillestar i humbjeve të shpërndarjes, të njohura në tarifat e shitjes, por jo në programin e reduktimit të humbjeve;
- Përfaqësimet dhe garancitë për hapjen e plotë të informacionit material.

Ndryshimi i kufizuar duhet të tregohet qartë në një faqe kapak, si “Ndryshim i kufizuar”, dhe të gjitha ndryshimet duhet të jenë të formës “Track-change”.

Përveç ndryshimit të kufizuar dhe ndryshimit të hapur (shih më poshtë), asnjë ndryshim tjetër nuk do të pranohet në marrëveshjen e blerjes së aksioneve.

Ofertuesit mundet, por nuk është e kërkuar, të paraqesin, përveç ndryshimit të kufizuar, një marrëveshje të blerjes së aksioneve, që përmban një ndryshim të hollësishëm (projekti aktual i propozuar dhe jo koncepte) në çdo seksion të marrëveshjes së blerjes së aksioneve, të zgjedhur nga ana e tyre (ndryshimi i hapur). Ndryshimi i hapur duhet të tregohet qartë në një faqe kapak si “Ndryshim i hapur”, dhe të gjitha ndryshimet duhet të jenë të formës “track-change”.

5.2.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do t'i vlerësojë ofertat teknike në bazë të vlerësimit kalon/nuk kalon (pass/fail). Objekt i vendimit përfundimtar të këtij paragrafi është:

i) nëse oferta respekton kushtet minimale të performancës teknike, të përcaktuara në aneksin 17, ajo do të vlerësohet “kalon”;

ii) nëse oferta nuk respekton kushtet minimale të performancës teknike, të përcaktuara në aneksin 17, ajo do të vlerësohet “nuk kalon”.

5.2.2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të të gjitha ofertave teknike, ua njofton rezultatin të gjithë ofertuesve, së bashku me datën, kohën dhe vendin e hapjes së ofertave financiare.”.

ë) Pika 5.3 “Hapja e ofertave financiare”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.3.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave hap zarfet e ofertave financiare vetëm të ofertuesve, oferta teknike e të cilëve është vlerësuar “kalon”.

5.3.2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të ketë tri (3) ditë kohë nga data e hapjes së ofertave financiare për t'i vlerësuar ato, në përputhje me pikën 5.3. Ofertat financiare renditen në bazë të çmimit të kufizuar të blerjes, që përmbahet në këto oferta financiare, nga çmimi më i lartë në atë më të ulët. Një renditje e ngjashme bëhet edhe bazuar në çmimin e hapur të blerjes (por kjo renditje do të jetë për qëllime indikative, për “BATO Stage”, si përshkruhet më poshtë).

5.3.3. Brenda tri (3) ditëve nga data e hapjes së ofertave financiare, kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përgatit një raport përmbledhës (“Raporti fillestar i vlerësimit”). Gjithashtu, ai mund:

i) të propozojë një ofertues të parapëlqyer për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

ii) të procedojë në “BATO Stage”, sikurse përcaktohet në pikën 5.3.5, më poshtë.

Raporti fillestar i vlerësimit përfshin:

a) Objektin e procesit të tenderimit dhe përqindjen e aksioneve, të ofruara për shitje;

b) Një përmbledhje të shkurtër të procedurës dhe numrit të ofertave të dorëzuara;

c) Një përmbledhje të ofertave të dorëzuara;

ç) Vlerësimin e çdo oferte;

d) Një renditje të ofertuesve, në përputhje me vlerësimin e kryer për ofertat respektive;

dh) Një rekomandim:

i) të përzgjedhjes së një ofertuesi të parapëlqyer, në bazë të çmimit të kufizuar të blerjes;

ii) procedimi në “BATO Stage”.

5.3.4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të dorëzojë raportin fillestar të vlerësimit në Këshillin e Ministrave, nëse rekomandimi është për të përzgjedhur një ofertues të parapëlqyer, në bazë të çmimit të kufizuar të blerjes. Pas miratimit të ofertuesit fitues nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka të drejtë të hyjë në marrëveshje për blerjen e aksioneve me ofertuesin fitues, bazuar në ndryshimin e kufizuar.

5.3.5. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nëse do të rekomandojë të mos përzgjedhë një ofertues të parapëlqyer, sipas çmimit të kufizuar të blerjes, duhet të zbatojë procedurat e mëposhtme (“BAFO Stage”):

a) Të ruajë të gjitha ofertat teknike dhe ofertat financiare, të paraqitura nga ofertuesit, duke mbajtur konfidenciale sasitë e vendosura në çmimet e kufizuara të blerjes dhe çmimet e hapura të blerjes, të paraqitura nga ofertuesit, si dhe identitetin e një ofertuesi, që ka bërë komente në ndryshimin e kufizuar ose në ndryshimin e hapur. Duhet të ruajë edhe sigurimin e ofertës, për procedurat e përshkruara në shkronjat “b” e “c”, më poshtë:

b) Të përgatisë një marrëveshje të rishikuar të blerjes së aksioneve, bazuar në ato komente, të cilat duhet të përfshihen nga ndryshimet e kufizuara dhe ndryshimet e hapura, të paraqitura në ofertat fillestare (“BAFO SPA”). Këto “BAFO SPA” do të parashtrihen për ata ofertues, të cilët janë vlerësuar “kalon” për ofertat teknike të mëparshme (“BAFO-Ofertuese”).

c) Ofertuesit BAFO ftohen të paraqesin një ofertë më të mirë dhe përfundimtare (“BAFO Ofertë”) brenda 7 (shtatë) ditëve, duke përgatitur:

i) BAFO SPA (“BAFO ofertën teknike”);

ii) Një propozim financiar (“BAFO oferta financiare”), e cila duhet të përmbajë çmimin e BAFO ofertuesit, të shprehur si një vlerë fikse, në euro, për t'u paguar për blerjen e 76 % (shtatëdhjetë e gjashtë për qind) të aksioneve të OSSH-së, bazuar në BAFO SPA (“BAFO çmimi i blerjes”).

ç) Dispozitat në pikat 3.10, 4 e 5 zbatohen “mutatis mutandis” në ofertat BAFO. Gjithsesi duhet që oferta teknike BAFO të vlerësohet “kalon”, nëse ajo është paraqitur pa komente ose kushte, dhe “nuk kalon”, nëse është ndryshuar ose me kushte, dhe parashikohet më tej që ofertat financiare BAFO të këtyre ofertuesve BAFO, që kanë marrë vlerësimin “kalon”, do të vlerësohen dhe renditen bazuar në çmimet e blerjes BAFO respektive.

d) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të paraqesë raportin e vlerësimit (“Raportin e vlerësimit BAFO”) në Këshillin e Ministrave. Pas miratimit të ofertuesit fitues nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka të drejtë të hyjë në marrëveshje për blerjen e aksioneve me ofertuesin fitues, bazuar në BAFO SPA.”.

f) Pika 5.7, “Miratimi i vlerësimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.7.1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do t’i paraqesë Këshillit të Ministrave raportin fillestar të vlerësimit ose raportin e vlerësimit BAFO, sipas rastit, me renditjen e ofertuesve. Këshilli i Ministrave miraton raportin e vlerësimit dhe shpall ofertuesin fitues.

5.7.2. Këshilli i Ministrave mundet, që, në çdo kohë, përpara shpalljes së ofertuesit fitues, të anulojë procedurën e tenderit, pa u dhënë argumente ofertuesve.”.

g) Në pikën 5.8, “Përcaktimi i ofertuesit fitues dhe sesionet e finalizimit”, bëhen këto ndryshime:

a) Nën-pika 5.8.1. ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.8.1. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës do të shpallë njoftimin për ofertuesin fitues, oferta e të cilit ka arritur pikët më të larta finale “Ofertuesi fitues”. Ofertuesi fitues do të ftohet të marrë pjesë në sesionet finalizuese të marrëveshjes së blerjes së aksioneve dhe duhet ta zbatojë këtë marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës mund të bëjë vetëm:

i) ndryshime të vogla në hartim, për të qartësuar dhe finalizuar marrëveshjen e blerjes së aksioneve ose të BAFO SPA, për çdo rast;

ii) ato ndryshime, nëse ka, të parashtruara në ndryshimin e kufizuar;

iii) me përjashtim të klauzolave të parashtruara në nënndarjen (ii) të vendimit, të përcaktuar më lart, ofertuesit fitues do t’i kërkohet të zbatojë marrëveshjen e blerjes së aksioneve në formën e kopjeve të nënshkruara, të dorëzuara si pjesë të ofertës së tij teknike.”.

b) Nën-pika 5.8.4. ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.8.4. Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të ofertuesit fitues, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i bëhet i ditur se ofertuesi fitues nuk do ta zbatojë marrëveshjen e blerjes së aksioneve, bazuar në ndryshimin e kufizuar ose në BAFO SPA, kjo ka të drejtë të konfiskojë garancinë e ofertës së ofertuesit fitues dhe të ftojë për negociata ofertuesit e tjerë, sipas renditjes, derisa marrëveshja e blerjes së aksioneve të zbatohet ose, në të kundërt, refuzon të gjitha ofertat e mbetura.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1270, datë 17.9.2008

PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z. BASHKIM GAZIDEDE, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për kurimin e z. Bashkim Gazidede, në Itali.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1271, datë 17.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1034, DATË 9.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KRYERJEN E TRANSPLANTIT TË VESHKËS, PËR DISA SHTETAS, NË ANKARA, TURQI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Në vendimin nr.1034, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
- a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“2. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, që, me fondin 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë, të kryejë transplantin e veshkës, për disa shtetas, përmes shoqërisë “Enar Saglik ve Egitim Hiz.Ltd”. ”.
 - b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të negociojë dhe të lidhë kontratën me shoqërinë “Enar Saglik ve Egitim Hiz.Ltd”, në Ankara, Turqi, për kryerjen e transplantit të veshkës, pranë qendrës spitalore “Ibni Sina Hastanesi Sihhiye” ose në qendrat spitalore, të autorizuara dhe nën përgjegjësinë e kësaj shoqërie, të licencuara për ofrimin e këtij shërbimi.”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1293, datë 27.9.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007 PËR ÇËSHTJEN “DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 13.11.2007, për çështjen nr.33771/02, “Driza kundër Shqipërisë”.
2. Autoritetet përgjegjëse për ekzekutimin e këtij vendimi janë Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë. Afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 30 shtator 2008.
3. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë ekzekutimin financiar të këtij vendimi në vlerë 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) euro.
4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të regjistrojë, në emër të shtetasit Ramazan Driza, parcelën me sipërfaqe 1 650 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë)m², aktualisht e regjistruar me nr.hipotekor 5924, datë 15.8.1996, në pronësi të shtetit.
5. Shuma 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) euro të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të shtetasit “Ramazan Driza”, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.
6. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj ankuesit, shtetasit Ramazan Driza, të bëhet nga Ministria e Financave, nga fondi i shpronësimeve në llogarinë speciale, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1294, datë 27.9.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007 PËR ÇËSHTJEN “RAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 13.11.2007 për çështjen nr.38222/02, “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në shumën 65 676 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 29 shtator 2008.

3. Shuma 65 676 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve “Ramadhi dhe të tjerë”, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj ankuesve “Ramadhi dhe të tjerë”, të bëhet nga Ministria e Financave, nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Detyrimi financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1317, datë 1.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.463, DATË 5.7.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E
MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin periudha “2007-2012” zëvendësohet me “2008-2014”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2008-2014, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore raportojnë pranë Ministrisë së Integritit, në fillim të çdo muaji, për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas metodologjisë, që hartohet nga kjo ministri. Grupi ndërministror i punës për shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, vlerëson dhe analizon, periodikisht, zbatimin e këtij plani.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1320, datë 24.9.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V ENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, përmasat e pronës “Reparti i policisë, Brisku”, sot “RESI”, në inventarin e miratuar për Ministrinë e Rendit Publik, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**FORMULARË PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE
INSTITUCIONI I PUSHTETIT QENDROR MB (Reparti Special RESI)**

Bashkia –Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës: ruajtje rendi

Nr rendor	A		B				C			
	Zona kadas. indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip.totale e pronës (m ²)	Nga sip.totale sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				Reparti special RESI	1710	1153	Ruajtje rendi	Ministria e Brendshme	Reparti special RESI	Sipas VKM nr.250, datë 24.4.2003 përfshihet prona e repartit policisë Brisku sot reparti special RESI në formularin nr.1, të inventarit të pronave të paluajtshme me numër rendor “1” me sipërfaqe totale prone 1690 m ² , me sipërfaqe ndërtese 852 m ² . Nga matjet faktike nga inxh. të licenc. si dhe nga harta treguese në ZRPP sipërfaqet reale janë: sipërfaqe totale prone 1710 m ² dhe sipërfaqe ndërtese 1153 m ²

VENDIM
Nr.1394, datë 17.10.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-
VJEÇARE, NË QYTETIN E BAJRAM CURRIT, TROPOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare në qytetin e Bajram Currit, Tropojë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Bajram Currit.

3. Pronarët e pasurive të paluajjtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3 945 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) m², tokë arë, e vlerësuar me 4 526 (katër mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë/m², në shumën e përgjithshme 17 855 070 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 193 500 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Bajram Currit.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 17 855 070 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit nëntor 2008.

7. Punimet për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në qytetin e Bajram Currit të fillojnë më 1.6.2009 dhe të përfundojnë brenda datës 31.12.2010.

8. Bashkia e Bajram Currit të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkia e Bajram Currit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SHKOLLËS
9-VJEÇARE BAJRAM CURRI, TROPOJË

Pronari	Z.K.	Nr.pas	Sip.are m ²	Çmimi arë lekë/m ²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale shpronësimi (lekë)
Rexhep Ibish Gjoçaj	1347	38/1/18	2463	4526	11147538	11147538
Rrustem Avdyl Gjoçaj	1347	38/1/19	1482	4526	6707532	6707532
Shuma			3945		17855070	17855070

Vlera totale e shpronësimit është 17 855 070 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë.

VENDIM
Nr.1397, datë 17.10.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI,
PËR ARSIMIN E MESËM, ME KOHË TË PLOTË, SI DHE MIRATIMIN E KUOTAVE TË
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN E
TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

- a) Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja:
 - i) Në lëndën “Gjuhë angleze”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën gjuhë angleze;
 - ii) Në lëndën “Gjuhë frënge”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën gjuhë frënge;
 - iii) Në lëndën “Gjuhë gjermane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën gjuhë gjermane;
 - iv) Në lëndën “Gjuhë italiane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën gjuhë italiane.
- b) Në Fakultetin Histori-Filologji:
 - i) Në lëndët “Gjuhë-Letërsi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndët gjuhë-letërsi;
 - ii) Në lëndën “Histori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën histori;
 - iii) Në lëndën “Gjeografi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi.
- c) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:
 - i) Në lëndën “Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën kimi;

ii) Në lëndën “Biologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën biologji;

iii) Në lëndën “Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën fizikë;

iv) Në lëndën “Matematikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën matematikë.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.

3. Kuotat e pranimeve në programet, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2008-2009, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja:

i) në lëndën gjuhë angleze 180;

ii) në lëndën gjuhë frënge 80;

iii) në lëndën gjuhë gjermane 80;

iv) në lëndën gjuhë italiane 120.

b) Në Fakultetin Histori-Filologji:

i) në lëndën gjuhë-letërsi 120;

ii) në lëndën histori 100;

iii) në lëndën gjeografi 100;

c) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) në lëndën biologji 60;

ii) në lëndën kimi 30;

iii) në lëndën fizikë 60;

iv) në lëndën matematikë 40.

4. Universiteti i Tiranës shpërndan kuotat e vëna në dispozicion në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti i Tiranës ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës, bëhen publike.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b/ii të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për këto programe, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

6. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër, të shurdhër, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë apo fëmijë të policëve, të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, të të ish-të përndjekurve politikë, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, master i nivelit të parë në mësuesi, në institucionet publike të arsimit të lartë, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Në çdo program studimi, në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë dhe nga cikli i dytë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës. Në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, për lëndët fizikë, matematikë apo kombinimet e tyre, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët me mesatare të ciklit të parë jo më ulët se nota 8 (tetë) nuk paguajnë tarifën e shkollimit.

9. Kuotat e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të përcaktuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1399, datë 17.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit n.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Lidhja nr.1/1, që përmendet në pikën 2/1 të vendimit nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.Efektet financiare për vitin 2008, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtron efektet financiare nga data 26.8.2008.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1400, datë 17.10.2008

PËR ORGANIZIMIN E KURSEVE NË SHISH DHE TRAJTIMIN E PJESËMARRËSVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 5, 6, 13, 22 e 30 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit (Instituti i SHISH-it) të organizohen kurse për përgatitjen informative e formimin bazë profesional, si dhe kurse të kualifikimit dhe të specializimit të punonjësve të SHISH-it, në funksion të sigurisë kombëtare.

Lloji dhe kohëzgjatja e kurseve përcaktohen me urdhër të drejtorit të SHISH-it.

2. Kursantët e rinj, për inspektorë dhe ndihmësinpektorë, gjatë kohës, që ndjekin kursin, marrin pagën e nivelit bazë, për klasë pa shtesa mbi pagë, dhe:

a) kur janë jashtë qendrës së tyre të banimit trajtohen në mensat dhe fjetoret e institutit dhe në filialet e trajnimit e të kualifikimit të këtij instituti, me ushqim pa pagesë, në kuotën 500 lekë/dita, dhe fjetje, pa pagesë, sipas normave të shpenzimeve, të miratuara nga drejtori i SHISH-it;

b) kur janë brenda qendrës së banimit u jepet një vakt ushqim, në masën deri 200 lekë për kursant.

3. Nëse në filialet e trajnimit dhe të kualifikimit të institutit nuk garantohet ushqim, kursantët dhe specialistët trajtohen me një dietë, në masën 900 lekë/dita, sipas pikës 7 të vendimit nr.228, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për dietat e nëpunësve, që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”.

4. Kursanti, i cili përfundon kursin bazë të formimit profesional dhe nuk paraqitet në detyrë pas emërimit, paguan të plota shpenzimet e bëra për trajnimin e tij.

5. Punonjësit, të cilët janë në marrëdhënie pune në SHISH ose në institucione analoge informative shqiptare dhe vazhdojnë kursin e përgatitjes e të formimit bazë profesional informativ, përfitojnë pagën mujore të funksionit organik, që kanë pasur para fillimit të kursit, dhe gjatë kursit nuk marrin dietë, por trajtohen me fjetje pa pagesë dhe me ushqim, në kuotën e përcaktuar nga drejtori i SHISH-it, deri në masën 800 lekë/dita për kursant.

6. Punonjësit nga institucionet jashtë SHISH-it, si të akademive ose universiteteve etj., të cilët do të angazhohen në procesin e mësimdhënies, të paguhen sipas kriterëve të përcaktuara për punonjësit mësimorë efektivë të universiteteve dhe shkollave të tjera të larta, në vendimin nr.1231, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve në disa institucione buxhetore”.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit, për institutin.

8. Kuotat e ushqimit dhe të fjetjes, të përcaktuara në këtë vendim, ndryshojnë në përputhje me indeksin e çmimeve të artikujve e të mallrave, me miratimin e Ministrisë së Financave.

9. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1403, datë 27.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.521, DATË 8.8.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E BLERJES NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË DISA
MALLRAVE TË PËRJASHTUARA NGA RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT
PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjave “a” e “b” të pikës 2, të nenit 5 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.521, datë 8.8.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a)Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.Miratimin e rregullores për procedurat e prokurimit, që do të zbatohen nga Ministria e Mbrojtjes, për prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve, që përjashtohen nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik, sipas shkronjave “a” e “b” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përcaktuar në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b)Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.Miratimi për prokurimin e armëve, të municioneve apo pajisjeve e materialeve ushtarake, veçmas a si pjesë e një sistemi, që gjykohet se ka ndikim të veçantë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, bëhet sipas pikës 15 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar.”.

c)Pika 3 shfuqizohet.

ç)Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4.Analiza, studimi, klasifikimi e vlerësimi i armëve, municioneve apo pajisjeve e materialeve ushtarake, veçmas apo si pjesë e një sistemi, dhe i shërbimeve, të lidhura me to, për të cilat do të zbatohet ky vendim, bëhen nga bordi i modernizimit, i ngritur në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Mënyra e funksionimit dhe përbërja e këtij bordi rregullohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.”.

2.Për procedurat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve, që përjashtohen nga prokurimet publike, të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për fazat e mbetura të procesit, të zbatohen rregullat e sipërpërmendura.

3.Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1404, datë 25.10.2008

PËR ORGANIZIMIN E CEREMONISË MORTORE, NË NDERIM TË TË NDJERIT, Z.BASHKIM GAZIDEDE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar dhe të pikës 11 të kreut VII, të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Organizimin e ceremonisë zyrtare, në nderim të figurës së të ndjerit z.Bashkim Gazidede, i cili, pas një sëmundjeje të rëndë, ndërroi jetë më 25.10.2008.

2.Ngritjen e komisionit shtetëror për kryerjen e ceremonisë mortore, në përbërje të të cilit të jenë:

-Enkelejd Alibeaj, ministër i Drejtësisë.

-z.Astrit Patozi, deputet;

-z.Gjergj Lezhja, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;

-z.Halit Shamata, zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës;

-z.Albert Kushti, sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit;

-z.Dhori Kule, rektor i Universitetit të Tiranës;

-z.Simon Miraka, drejtor i Përgjithshëm i Institutit për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë;

-znj.Natasha Shehu, ish-deputete;

-një përfaqësues i protokollit të Kuvendit të Shqipërisë.

3.Ceremonia e homazheve të organizohet ditën e diel, datë 26.10.2008, ora 12.00 deri 13.00, në mjediset e sallës së seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

4.Shpenzimet e varrimit dhe të ceremonialit të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

5.Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1428, datë 22.10.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 18.12.2007 PËR ÇËSHTJEN “MARINI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë, të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 18.12.2007, për çështjen nr.3738/02 “Marini kundër Shqipërisë“, në shumën 335 700 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind) euro.

2.Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 29 tetor 2008.

3.Shuma 335 700 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind) euro të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit “Marini kundër Shqipërisë“ dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

4.Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj ankuesit, shtetasit Vlash Marini, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5.Kundërvlefte në lekë e shumës së parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1439, 29.10.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT TË VEPRIMTARIVE E TË PROJEKTEVE, ME NDIKIME TË RËNDËSISHME NEGATIVE NË MJEDISIN E VENDEVE FQINJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 2 të ligjit nr.9700, datë 26.3.2007 “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkuftare”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe të procedurave, të cilat do të zbatohen për vlerësimin e veprimtarive të projekteve, që mund të kenë ndikime të rëndësishme negative në mjedisin e vendeve fqinje.

A. Shqyrtimi i projektit nga Agjencia Rajonale e Mjedisit (më poshtë ARM)

A.1. Brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës për zbatimin e një projekti në një zonë ndërkuftare, ARM-ja vlerëson dhe vendos nëse projekti:

- i) bën pjesë në aneksin I, të konventës;
- ii) do të ketë ndikime të rëndësishme negative në mjediset e vendeve fqinje, bazuar në kërkesat e shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë e tij;
- iii) do t'i nënshtrohet përgatitjes së raportit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

A.2. ARM-ja njofton zyrtarisht propozuesin për rezultatin e vlerësimit, sipas pikës A.1 të këtij vendimi.

A.3. ARM-ja përcjell në ministrinë e fushës (më poshtë ministria) dosjen, të shoqëruar me vlerësimin e saj, me shkrim, në përputhje me dispozitat e nenit 14 të ligjit nr.8990, datë 23.1.2004, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

B. Veprimet e ministrisë

B.1. Kur ministria është dakord me vendimin e ARM-së, njofton institucionin, që ka kompetencë të licencojë projektin, njësinë e qeverisjes vendore, ku ai do të zbatohet, dhe pjesën shqiptare të komisioneve të përbashkëta, të ngritura për çështje të ndryshme ndërkuftare, dhe u kërkon të angazhohen në procesin e vlerësimit, në përputhje me funksionet e kompetencat e tyre ligjore.

B.2. Brenda 10 ditëve nga njoftimi i ARM-së, ministria njofton palën e prekur, për projektin, që do të zbatohet se, meqenëse parashikohet të ketë ndikime të rëndësishme negative ndërkuftare, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm), në kontekst ndërkuftar.

B.3. Nëse pala e prekur nuk shprehet brenda afatit njëmuajor, të caktuar në njoftimin e ministrisë, shqyrtimi dhe miratimi i projektit kryhen pa praninë e saj, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

B.4. Kur pala e prekur shfaq interes dhe parashtron kërkesa, ministria pranon dhe shqyrton vetëm kërkesat që janë në përputhje me dispozitat e konventës dhe i dërgon asaj:

- i) informacion për projektin e propozuar dhe për vlerësimin paraprak, të bërë nga ARM-ja;
- ii) informacionin për procedurën kombëtare të vnm-së e të tërheqjes së mendimit të publikut të ndikuar;
- iii) vendimin përfundimtar të ministrit.

B.5. Komunikimi me palën e prekur bëhet në gjuhën angleze, nëpërmjet personit të kontaktit, të caktuar nga ministri.

B.6. Shpëzimet për përkthimet e dokumentacionit dhe përkthimet gjatë takimeve, në kuadër të procesit të vnm-së ndërkuftare, përballohen nga propozuesi.

C. Dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit në mjedis

C.1. Menjëherë pas përgatitjes së raportit të vnm-së, personi i kontaktit, në ministri, i dërgon autoritetit kompetent të palës së prekur dokumentacionin, i cili përmban, së paku, :

- i) përshkrimin e projektit dhe qëllimet;

- ii) përshkrimi i mjedisit të zonës, ku do të zbatohet projekti;
- iii) ndikimet e rëndësishme negative në mjedis;
- iv) masat, që do të ndërmerren nga propozuesi, për zbutjen e ndikimeve negative;
- v) programin e monitorimit dhe planin e menaxhimit, nëse është kërkesë ligjore për projektin;
- v) një përmbledhje joteknike, përfshirë dhe paraqitje vizuale, si harta grafike, imazhe, etj.

Ç) Këshillimi me palën e prekur

Ç.1 Gjatë procesit të vnm-së në kontekst ndërkufitar, ministria këshillohet me palën e prekur. Këshillimi mund të bëhet edhe nëpërmjet grupeve të përbashkëta të punës, të ngritura posaçërisht për shqyrtimin e projektit.

Këshillimet ndërmjet palëve zhvillohen për afatet, mënyrën e shkëmbimit të dokumentacionit, të njoftimit të aktorëve të interesuar e të publikut të palës së prekur, përfshirë, gjithashtu,:

i) numrin e kopjeve të raportit të vnm-së, vendin dhe afatin kohor të nevojshëm për t'iu vënë në dispozicion publikut, OJF-ve dhe autoritetit kompetent të palës së prekur;

ii) mënyrën e mbledhjes së komenteve, të bëra nga publiku i palës së prekur, dhe dërgimin e tyre në ministri;

iii) mënyrën e njoftimit të vendimit përfundimtar të ministrit.

Ç.2 Për tërheqjen e publikut e për të gjitha procedurat e tjera, ministria zbaton kërkesat e legjislacionit mjedisor shqiptar.

Ç.3 Këshillimi ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve mund të realizohet edhe për alternativat e mundshme të ushtrimit të veprimtarisë së propozuar, masat, që duhet të merren për minimizimin e ndikimeve të rëndësishme negative ndërkufitare dhe monitorimin e efektshmërisë së masave, të marra nga propozuesi e nga autoritetet mjedisore shqiptare.

D. Marrja e vendimit

D.1 Ministria siguron se vendimi përfundimtar për projektin e propozuar është i bazuar në dokumentacionin dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedisin ndërkufitar, në komentet e publikut, si dhe në rezultatet e këshillimeve, të realizuara me shtetin fqinj.

D.2 Ministria, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar për zhvillimin e veprimtarisë në zonë ndërkufitare, ia njofton atë palës së prekur, së bashku me arsyetimet, të cilat është mbështetur.

D.3 Nëse ministria, pa filluar zbatimin e projektit, merr informacion të ri për ndikime të tjera mjedisore negative ndërkufitare, të cilat mund të shfaqen, por që nuk ishin të ditura në çastin kur mori vendimin përfundimtar dhe që mund të kenë ndikuar në përmbajtjen e tij, informon palën e prekur.

D.4 Kur pala e prekur kërkon rishikimin e vendimit përfundimtar, ministria hyn në këshillime, nëse është ose jo e nevojshme të rishikohet vendimi.

D.5 Vendimi i Ministrit bëhet publik dhe u njoftohet palëve të interesuara.

DH. Analiza e veprimtarisë gjatë ushtrimit të saj

Dh.1 Ministria, kur autoriteti kompetent i palës së prekur kërkon kryerjen e analizës për ndikimet mjedisore ndërkufitare, pasi projekti ka filluar të zbatohet, zhvillon këshillime me palën e prekur dhe vendos nëse analiza duhet të kryhet, duke përcaktuar edhe çështjet, që do të trajtohen në të.

Dh.2 Analiza do të fokusohet në rivlerësimin e çdo ndikimi negativ, përtej kufijve të parashikuar gjatë vendimmarrjes, përfshirë edhe çështjet e mëposhtme:

i) monitorimin e zbatimit të lejes mjedisore, si dhe efektshmërinë e masave të marra për zbutjen e ndikimeve mjedisore;

ii) rivlerësimin e ndonjë ndikimi mjedisor negativ, për përmirësimin e masave për kontrollin e tij;

iii) verifikimin e parashikimeve të ndikimeve mjedisore, në mënyrë që të shërbejë si përvojë për veprimtari të njëjta, në të ardhmen.

2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 3 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1
IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME MJEDISORE NDËRKUFITARE

Kritere të përgjithshme për të ndihmuar në vlerësimin e veprimtarisë sipas kërkesës së pikës 1.1.b të këtij vendimi.

1. Madhësia e projektit: Lloji i veprimtarisë, sipërfaqja e tokës që do përdoret dhe operacionet që do të kryhen në të, kapaciteti prodhues dhe lëndët e para, përdorimi i burimeve natyrore dhe sasia e tyre, lloji dhe sasia e shkarkimeve në mjedis, kërkesat dhe konsumi i energjisë, objektet dhe infrastruktura që do të ndërtohet, lloji i mbetjeve dhe sasia e gjenerimit të tyre.

2. Vendosja: Veprimtaria e propozuar do të zhvillohet në zonë ndërkufitare dhe pranë vijës kufitare, në një zonë të mbrojtur, me rëndësi ndërkombëtare, pranë burimeve ujore, në një zonë me ndjeshmëri ekologjike (habitat i llojeve) afër qendrave të banuara dhe në afërsi të objekteve kulturore, në një terren të pjerrët me ekspozim nga territori i shtetit fqinj.

3. Pasojat: Veprimtaria e propozuar do të ketë ndikime të rëndësishme negative mjedisore që dalin përtej kufijve territorialë të Republikës së Shqipërisë dhe në shkallë të ndryshme ndikojnë negativisht në vlerat natyrore të shtetit/eve fqinje, si dhe në shëndetin e popullsisë. Në disa raste, veprimtaria e propozuar mund të shkaktojë efekte të rëndësishme ndërkufitare shumë të zhvendosura nga vendi i zhvillimit të saj dhe që mund të kalojnë përtej kufijve të një shteti fqinj.

Çështje që duhet të merren në konsideratë lidhur me vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve mjedisore:

1. Shkarkimet në ajër të gazeve ndotëse që mund të ndryshojnë cilësinë e ajrit në zonë;
2. Shkarkimet e lëndëve ndotëse në ujërat sipërfaqësore, përrrenj, lumenj, liqene dhe det;
3. Prerje masive drurësh apo shpyllëzim në sipërfaqe të konsiderueshme;
4. Afërsia e vendndodhjes së projektit me zona të mbrojtura;
5. A mundet që aktiviteti i propozuar të shkaktojë aksidente që mund të kenë ndikime ndërkufitare?
6. A lidhet aktiviteti i propozuar me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare për çështjet mjedisore?

VENDIM
Nr.1447, datë 5.11.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUARA PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR TRAJTIMIN ME DIALIZË TË NJË NUMRI TË SËMURËSH ME INSUFICIENCË RENALE KRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të viti 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në artikullin “Shpenzime për mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin me dializë të një numri të sëmurësh me insuficiencë renale kronike.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1448, datë 5.11.2008

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE NDËRQEVERITARE, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM, PËR
VITIN 2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve ndërqeveritare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin për zhvillim, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1460, datë 5.11.2008

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.535, DATË 4.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, TË INSTITUTIT TË STUDIMIT TË TOKAVE DHE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.535, datë 4.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “... kati përdhe...” të shtohen “... kati i parë...”.

2. Pas pikës 2 të shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1. Mjediseve të ndërtesës dykatëshe të laboratorit të ish-Institutit të Studimit të Tokave (sot Qendra për Transformimin e Teknologjive Bujqësore), të cilat janë në administrim të këtij të fundit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Instituti i Studimit të Tokave te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtë vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1475, datë 12.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.598, DATË 5.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE TË NDËRMARRJES
SHTETËRORE “SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 31 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8 e vendimit nr.598, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, sh.a. me kapital shtetëror, t’i transferohen teknologjia dhe të gjitha makineritë e përdorura për shtypjen e pullave fiskale. Procedura e transferimit të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1497, datë 19.11.2008

PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtypja e letrave me vlerë realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, sh.a. me kapital shtetëror, në varësi të Ministrit të Financave.

2. Letra me vlerë, në kuptim të këtij vendimi, do të vlerësohen pullat fiskale, biletat e transportit rrugor dhe hekurudhor.

3.Procedurat, afatet dhe çështje të tjera, që lidhen me prodhimin e letrave me vlerë, rregullohen me udhëzimin e Ministrit të Financave që do të dalë brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Vendimet nr.402, datë 6.8.1993 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, dhe nr.183, datë 28.3.2007 “Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave të transportit rrugor” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 2.8.2010

Doli nga shtypi më 4.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë